Mësimi i misionit

Viti i 3-të – Tremujori i 4-ët

Shërbesa ndërkulturore në qytetin e New York-ut

Qëllimi: T'i ndihmojmë nxënësit të mësojnë për shërbesat ndërkulturore duke parë qytetin e New York-ut dhe pesë besime fetare botërore.

Përmbledhje e mësimit: Nxënësit do të qëndrojnë pas disa fletëve të vendosura përreth një harte të botës në dysheme. Mësimi do të nisë me fakte për qytetin e New York-ut dhe për njerëzit nga shtete të ndryshme që jetojnë atje – shumë prej të cilëve nuk kanë dëgjuar kurrë për Jezusin. Për të treguar llojshmërinë e kulturave në NY, nxënësit do të hedhin një top me fije leshi te njëri-tjetri, duke nxjerrë një pjesë të fijes në çdo rrotullim, për të formuar një rrjetë merimange me fije. Kur fija të arrijë te njëri nga nxënësit që qëndron pas fletës së fesë, drejtuesi do të lexojë disa fakte kyç rreth asaj feje. Kur të përfundojë rrjeta, letra me fjalën "Jezus" vendoset në qendër për të treguar se çdokush ka nevojë për Të. Fletë shtesë i shtohen rrjetës për të treguar mënyrat se si të krishterët e tregojnë dashurinë e Perëndisë në qytetin e New York-ut. Në fund, nxënësit i kthejnë fletët e feve në anën ku shkruhet "Jezus" ndërkohë që shpjegohet Ungjilli dhe mësimi përfundon me një lutje të shkurtër për misionarët, dhe që njerëzit në New York të njohin Jezusin.

Mjetet dhe ambienti:

- Prezantimi me PowerPoint (burim i printueshëm)
- Foto të njerëzve nga kultura të ndryshme të varura nëpër dhomë (burim i printueshëm; mund t'i printosh të gjitha fotot ose të zgjedhësh disa dhe t'i shfaqësh)
  - Alternativë: Nëse nuk arrin dot t'i printosh e as t'i shfaqësh fotot, printo gjashtë diapozitivat e para të PowerPoint-it dhe kaloji në rreth

- Fleta (nga një për çdo nxënës), vendosini në dysheme përreth hartës:
  - Pesë letra do të kenë një fe nga njëra anë dhe pikat e Ungjillit dhe fjalën "Jezus" nga ana tjetër (burim i printueshëm)
- Një fije leshi shumëngjyrëshe (ose disa fije leshi në ngjyra të ndryshme) për të formuar një "rrjetë merimange" (shih pamjen për të kuptuar se si duhet të duket rrjeta gjatë aktivitetit)
- Letra për t'i vendosur te rrjeta me fije (burim i printueshëm)
- Libri pa fjalë
- Alternativë: Kapëse rrobash për të varur posterat në rrjetë

Mënyra për t'i dhënë "energji" mësimit të misionit:

- Vendos një pamje të qytetit të New York-ut në një nga faqet e murit
- Zbukuroje dhomën me elementë të qytetit: Statuja e lirisë, taksi të verdha, hot dog, etj.
- Shfaq një video të rrugëve të New York-ut ose të metrosë (këto video mund të gjenden në YoutTube, thjesht sigurohu që të jenë të përshtatshme për fëmijë)



Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Shënime për drejtuesin:

- Sigurohu të lexosh fakte për pesë fetë paraprakisht, që të jesh i përgatitur t'ua shpjegosh nxënësve.
- Në këtë mësim ka edhe një mundësi alternative për të diskutuar grupet e paungjillëzuara të njerëzve në New York, me nxënësit më të rritur. NY-u është bërë "shtëpi" për shumë grupe të paungjillëzuara! Është e mrekullueshme të shohësh se si Perëndia e bën misionin më të arrirë duke i dërguar njerëzit në Shtetet e Bashkuara, ku mund të dëgjojnë lirisht për Ungjillin dhe të lexojnë Biblën. Për të mësuar më shumë rreth grupeve të paungjillëzuara të njerëze në SHBA, kontrolloni: https://joshuaproject.net/countries/US dhe https://upgnorthamerica.com/northamerica-unreached-people-group-matrix/

Mësimi:

Ndërkohë që vijnë nxënësit, kërkoju të ulen ose të qëndrojnë pas njërës prej letrave, duke formuar një rreth.

(*Diapozitivat 1-6*) A e gjeni dot se për cilin vend do të mësojmë sot? Shikojini me kujdes këto foto. *Nxiti nxënësit të përgjigjen.*

(*Diapozitivi 7*) Sot do të mësojmë për një qytet të madh të quajtur New York, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës! *Drejtohu te harta.*

Shtetet e Bashkuara është një komb i madh me më tepër se 340 milionë njerëz![1] New York-u është qyteti më i madh në Sh.B.A., me mbi 8 milionë banorë! Njerëz nga e gjithë bota jetojnë në New York, duke sjellë me vete gjuhën, ushqimet dhe traditat e tyre.

(*Diapozitivi 8*) Pamjet që pamë mund t'ju ndihmojnë të imagjinoni se si është të ecësh nëpër rrugicat e New York-ut. Mbi 700 gjuhë fliten në atë qytet![2] Si mendoni se është të jetosh në një qytet me kaq shumë gjuhë të ndryshme? *Nxiti të përgjigjen.*

(*Diapozitivi 9*) Rreth një në tre persona në New York ka lindur në një shtet tjetër.[3] Disa njerëz shpërngulen atje për shkollë, për një punë apo për të qenë pranë familjes. Të tjerë duhet të lënë shtetet e tyre për shkak të luftës, për shkak se nuk kanë mjaft ushqim ose sepse nuk ndihen të sigurt në vendin e vet. Disa vijnë nga vende ku është kundër ligjit të mbash një Bibël dhe të flasësh për Jezusin. Mirëpo, kur shkojnë në Sh.B.A, më në fund mund të mësojnë për Jezusin!

Alternativë për nxënësit më të rritur: A ju kujtohet se çfarë është "një grup njerëzish të paungjillëzuar"? Është një grup njerëzish që nuk kanë dëgjuar se Jezusi erdhi për të qenë Shpëtimtari i tyre. Në New York ka mbi 50 grupe njerëzish të paungjillëzuar![4]

- https://share.america.gov/united-states-is-rich-in-languages/
- https://languagemap.nyc/info/About
- https://www.nyc.gov/site/internationalbusiness/why-nyc/a-diverse-global-city.page
- https://envisionnyc.org/purpose

Ky është fakt entuziazmues! Ndonjëherë është e vështirë apo e rrezikshme që misionarët të shkojnë në shtetet e tyre, mirëpo tani Perëndia ka lejuar që këto grupe të shkojnë atje që të mund të shpallet Lajmi i Mirë me ta!

(*Diapozitivi 10*) Le të bëjmë një rrjetë për të kuptuar më mirë qytetin e New York-ut dhe disa prej feve që mund të gjejnë atje. Nëse nxënësit janë ulur, thuaju të ngrihen në këmbë. Jepu fijen e leshit dhe kërkoju ta hedhin te njëri-tjetri, duke mbajtur një fije vetë, kështu do të krijojnë rrjetën.

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

Kur një nxënës, i cili qëndron pas një flete me njërën nga besimet fetare kap topin, ndaloni pak dhe lexoni faktet që gjenden te fleta. Ja të gjitha faktet që do të përmendni gjatë aktivitetit (drejtuesi duhet t'i kontrollojë paraprakisht)

Budizmi:

- Ndjekin mësimet e një burri të quajtur Buda.
- Përpiqen të kuptojnë jetën e të bëjnë të mira, që të mund të gjejnë paqe e të çlirohen nga vuajtjet (këtë e quajnë "ndriçim")
- Nuk besojnë në Perëndinë e Vërtetë.

Islami:

- Besojnë në një zot, të quajtur "Allah" (jo Perëndia i vërtetë i Biblës).
- Përpiqen të sillen mirë duke ndjekur rregullat e Allahut, që të fitojnë aprovimin e tij.

Hinduizmi:

Judaizmi:

- Përqendrohet të ndjekë rregullat e Perëndisë në Torah (pesë librat e parë të Biblës), mirëpo nuk besojnë se Jezusi është Shpëtimtari.
- Akoma presin Shpëtimtarin e premtuar (Mesian).

Sikizmi:

- Besojnë në një zot (jo Perëndia i vërtetë i Biblës).
- Ndjekin mësimet e drejtuesve të tyre fetarë, të quajtur "guru".
- Përpiqen të jetojnë me ndershmëri, t'i ndihmojnë të tjerë dhe të jenë të sjellshëm që të afrohen me perëndinë e tyre.

Vazhdoni të kaloni topin e fijes, deri sa të jetë formuar rrjeta.

New York-u është si kjo rrjetë, me shumë kultura, gjuhë dhe fe të ndryshme, të gjitha të mbledhura në një vend. A nuk është e mrekullueshme që Perëndia lejon që njerëz të ndryshëm nga e gjithë bota të bashkohen në një qytet?

Çdo person – pavarësisht se ku jeton apo se çfarë beson – ka diçka të përbashkët me të gjithë të tjerët. A dini se çfarë është? *Nxiti të përgjigjen.* Çdo person ka nevojë për Jezusin. *Vendose fletën që thotë "Jezus" në mes të rrjetës.*

(*Diapozitivi 11*) Në New York ka misionarë që flasin për Jezusin me të gjithë njerëzit, sidomos me ata nga shtete të huaja. Ata e tregojnë dashurinë e Perëndisë kështu:

- duke u mësuar njerëzve anglisht;
- duke i shoqëruar nëpër takime;
- duke i ndihmuar me përkthim në shkollë;
- duke ndrequr gjëra të prishura nëpër shtëpitë e tyre;
- duke i vizituar e duke u bërë miq me ta.

Ndërsa përmend secilën prej pikave, vendos edhe fletë përkatëse në rrjetë që drejton te "Jezus".

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association

(*Diapozitivi 12*) Ndërsa ata i ndihmojnë njerëzit dhe ndërtojnë marrëdhënie me ta, kanë mundësinë të tregojnë për Jezusin dhe të shpjegojnë Ungjillin. *Ngri lart "Librin pa fjalë".* Nëse njerëzit nga sfonde të tjera fetare besojnë në Jezusin si Zoti dhe Shpëtimtari i tyre, marrin falje dhe shpëtohen!

Të gjithë nxënësit që qëndrojnë pas fletëve me besimet fetare, duhet ta kthejnë nga ana ku shkruhet "Jezus" pastaj të lexojnë pikën e Ungjillit që i përket çdo flete:

- Pas letrës së Budizmit: Paqja e vërtetë vjen vetëm prej Jezusit. Kur ne besojmë tek Ai si Shpëtimtari ynë, Ai na jep gëzim dhe paqe që zgjat gjithmonë – edhe kur jeta bëhet e vështirë.
- Pas letrës së Islamit: Ne nuk mund ta fitojmë dashurinë dhe faljen e Perëndisë. Jezusi erdhi që ne të marrim falje dhe të mund të jemi me Perëndinë përgjithmonë.
- Pas letrës së Hinduizmit: Edhe kur bëjmë më të mirën, gjithsesi mëkatojmë. Kemi nevojë që Jezusi të na falë e të na japë jetë të re.
- Pas letrës së Judazimit: Lajm i Mirë... Shpëtimtari tashmë ka ardhur! Jezusi është Mesia që Perëndia premtoi në Dhiatën e Vjetër.
- Pas letrës së sikizmit: Bërja e gjërave të mira nuk e heq mëkatin. Vetëm Jezusi mund të na falë e të na ndihmojë t'i afrohemi Perëndisë së vërtetë.

(*Diapozitivi 13*) Para se të përfundojmë mësimin, le të ndalemi e të lutemi:

- që misionarët të gjejnë forma krijuese për të treguar Ungjillin;
- që njerëzit në New York të duan të dëgjojnë më tepër për Jezusin;
- që njerëzit t'i besojnë Jezusit si Zoti dhe Shpëtimtari i tyre.

Mbylleni me lutje!

Të gjitha të drejtat e rezervuara; Copyright 2026 Appleton Alliance Association